




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA		REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep.	2-D / DPK	Nr. Prot.
Dep.		B/ Prot.
Dep.		Prot No.
Nr. i fajl	03	01-2083/2012
Broj stranica		Date
Nr. pages		Datum
13.06.2012		
DREJTORI I AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT		



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.05.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I.** Mbyllët rasti me nr. AKK- 03-4394/11, për, **z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës**, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

**I.** Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli, AKK- 03-4394/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë **z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës**. Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit të gjendjes, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në ketë periudhë, pasi qe **z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës**, me datën 19.12.2011, i është drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit me kërkesën për interpretim dhe vlerësimin e gjendjes se mundshme te Konfliktit te interesit ne procesin e nënshkrimit te kontratës me kompani N.Sh.CMB dhe ko producentit P.K.Issstra ,ne te cilën ko producent dhe bashkëpronare ne ketë kompani është **z.Shkumbin Istrefi** me te cilin thotë se ka lidhje familjare,(është i martuar me motrën e tij).

Kjo kompani dhe Projekti filmik me datën 19.11.2011,është përgjedhur nga juria vlerësuese e QKK-së, si njeri nder projektet fituese, ndërsa ne te njëjtën datë Këshilli drejtues i QKK-së, ka sjell vendim për subvenzonimin e projekteve filmike për vitin 2011,bazuar ne ligjin për Kinematografin, e ku njëra nga fitueset e konkursit vjetor për projektet filmikë, te hapur nga QKK-ja ne muajin Maj –Qershori 2011,eshte Projekti filmik “Tri Dritare dhe një Varje”.me skenar te Zymer Kelmendit dhe regji te Isa Qosjes i Kompanis N.SH.CMB.

Zyrtari i Lartë z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, ne kërkesën e tij e përshkruan procesin e përgjedhjes se tij si drejtor i QKK-së, si dhe procesin e projekteve filmi ke qe do te subvencionohen nga QKK-ja, e qe janë përgjedhur nga juria vlerësuese te emëruara nga këshilli Drejtues i QKK- së.

Pas analizimit te gjendjes zyrtaret e Agjencisë kanë kontaktuar me z.Fatos Berisha dhe janë takuar për te biseduar lidhur me situatën e mundshme te konfliktit te interesit. Ne takim e mbajtur është pyetur për procesin e emërimit te tij dhe përgjedhjen e projekteve filmike qe do te subvencionohen nga QKK-ja, si dhe është kërkuar nga aj qe ti paraqet dokumentacionin lidhur me ketë proces.

Zyrtaret e agjencisë e kane njoftuar z.Fatos Berisha, se pa së analizimit dhe vlerësimit te kësaj gjendje dhe dokumentacionit te ofruar, do ta njoftojnë me shkrim për hapat qe duhet ndërmarrë aji për situatën qe gjendet.

Me datën 22.12.2011, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar me shkrim z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës se nënshkrimi i kontratës nga ana e tij me kompaninë N.SH.CMB , ku, ko producent është z.Shkumbin Istrefi, me te cilin z.Berisha ka lidhje familjare e qe është njëra nder kompanitë e përgjedhura nga juria vlerësuese për projektin filmik “Tri Dritare dhe një varje” më skenar te Zymber Avdiut dhe regji te Isa Qosjes, qe do të subvencionohen nga QKK-ja, nuk duhet te nënshkruhet nga ana tij por te delegohet nga organi apo institucioni me i lartë mbikëqyrës, për arsy se ne te kundërtën ne bazë te informacioneve dhe provave qe disponon Agjencia kundër Korrupsionit gjithnjë duke u bazuar ne Ligjin për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L.051, do te shfaqe gjendja e Konfliktit te Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Me datën 02.03.2012, Ministria e Kulturës ka sjellë Kontratën dhe korrespondencën qe z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës ka pasur me Sekretarin e Përherëshëm te Ministrisë se Kulturës, lidhur me delegimin e kompetencës për nënshkrimin e vendimit apo kontratës lidhur me kompaninë e përgjedhur nga juria vlerësuese për projektin filmik “Tri Dritare dhe një varje” më skenar te Zymber Avdiut dhe regji te Isa Qosjes, pas shkresës njoftuesc nga Agjencisë kundër Korrupsionit, për veprimet qe duhet marrë, për te mos u gjendur ne gjendje te konfliktit te Interesit.

Pas analizimit te dokumentacionit Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, nuk ka qenë nënshkrues i kontratës për subvencionimin e projektit filmik te përgjedhur nga juria vlerësuese e QKK-së, andaj konsiderojmë se z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, me delegimin e kompetencës për nënshkrim te Kontratës, tek organi mbikëqyrës me i lartë i tije , ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit te Interesit, pasi qe nuk ka qen personi qe ka nënshkruar dhe vendosur për zgjedhjen e këtij projekti dhe nuk ka nënshkruar kontratën ne te cilën munde te shkaktonte gjendjen se konfliktit te interesit.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)



Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit